



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/04
Datë: 13.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 13, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 500,000€ (pesëqind mijë eurosh), për mbështetjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës të prekur nga situata e sigurisë në rajonin e Lindjes së Mesme, përfshirë edhe ata që kanë mbetur të bllokuar apo të strehuar si pasojë e zhvillimeve të fundit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 232, nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me kod 216, në nënprogramin "Ambasadat" me kod 14300, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/04
Datë: 13.03.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe i ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31, të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49, të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62, të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90, të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99, të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140, të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159, të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178, të datës 13.12.2023, Vendimin Nr. 43/178, të datës 13.12.2023, Vendimin Nr. 01/241, të datës 27.12.2024, dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 02/270, të datës 07.10.2025, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 1,675,000.00€ (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetepesë mijë eurosh), për zbatimin e Masave 3.6 dhe 3.8 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Financave, me kod 201, në nënprogramet si në vijim:
 - 2.1. Në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", ndahen mjete në shumë prej 75,000.00€ (shtatëdhjetepesë mijë eurosh), për zbatimin e Masës 3.6 – Mbështetja e likuiditetit familjar të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, për mbështetjen e studentëve, me shumën e njëhershme prej 100€ (njëqind eurosh) me rastin e fillimit të vitit të ri akademik.
 - 2.2. Në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", ndahen mjete në shumë prej 1,600,000.00€ (një milion e gjashtëqind mijë eurosh), për zbatimin e Masës 3.8 - Bursa e Mobilitetit për Studentë.
3. Mjetet, sipas këtij Vendimi, transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/04
Datë: 13.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 13, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri që t'i aprovojë transferet nga nënprogrami "Shpenzimet e Paparashikuara" në ndonjë nënprogram tjetër, në tabelat 3.1 dhe 4.1 të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, për shumat individuale të kërkuara deri në vlerën prej 40,000€ (dyzet mijë eurosh).
2. Shuma e përgjithshme e autorizimit, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të shumës së ndarë vjetore të nënprogramit "Shpenzimet e Paparashikuara".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/04
Datë: 13.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumën prej 370,000.00€ (treqind e shtatëdhjetë mijë eurosh), për Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim (International Development Association - IDA).
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Kontigjencat në Ministrinë e Financave" me kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në Ministrinë e Financave, me kod 201, në nënprogramin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Autorizohet Thesari që ta realizojë transferimin e mjeteve buxhetore, në përputhje me këtë Vendim, në llogarinë përkatëse bankare, në shumën prej 420,000.00 USD (katërqind e njëzet mijë dollarësh amerikanë), të konvertuar sipas kursit zyrtar valutor në fuqi në ditën e realizimit të pagesës.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/04
Datë: 13.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafëve 1, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Financave për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për dhënien e Autorizimit, Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW, Frankfurt Am Main, për Programin e Kredisë, të Bazuar në Politika në sektorin e Energjisë dhe Klimës për Kosovën.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij Vendimi, konform afatit të përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë